

UNIVERSITETI “FEHMI AGANI” GJAKOVË

FAKULTETI I MJEKËSISË

PROGRAMI: INFERMIERI



Punim Diplome

**SFIDAT E SISTEMIT SHËNDETËSOR PËR
KUJDESIN NDAJ POPULATËS SË MOSHUAR**

Kandidatët:

Dorëntina Lushaj

Besarta Biraj

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Dardan Koçinaj

Gjakovë, 2019

INFORMATA RRETH PUNIMIT

Punimi i diplomës me titull: “**SFIDAT E SISTEMIT SHËNDETËSOR PËR KUJDESIN NDAJ POPULATËS SË MOSHUAR**”, i kandidateve: **Dorëntina Lushaj** dhe **Besarta Biraj**, u pranua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë.

Mentor i punimit: **Prof. Ass. Dr. Dardan Koçinaj** - Profesor i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin “Fehmi Agani” Gjakovë.

Punimi përmbanë:

- 44 faqe
- 17 tabela dhe
- 17 grafikone

Në mbështetje të Rregullores për studime themelore të Fakultetit të Mjekësisë neni 46 dhe të vendimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë të datës 02.10.2017 nr. ref.005/ 368 deklarojmë se:

- Pjesa e temes së diplomes “Sfidat e sistemit shëndetësor për të moshuarit” duke përfshirë pjesën nga hyrja, kujdesin infermieror për të moshuarit si dhe qëllimin dhe metoden e punës janë punuar nga unë Dorëntina Lushaj, ndërsa
- Pjesa temes “Sfidat e sistemit shëndetësor për të moshuarit” duke përfshirë rezultatet, diskutimi, përfundimi dhe rekomandimet janë punuar nga unë Besarta Biraj.

DEKLARATA STUDENTORE

Unë Dorëntina Lushaj dhe unë Besarta Biraj në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, Fakulteti i Mjekësisë, Drejtimi: Infermieri, deklarojmë se punimi i titulluar: **SFIDAT E SISTEMIT SHËNDETËSOR PËR KUJDESIN NDAJ POPULATËS SË MOSHUAR** është puna jonë origjinale. Punimi nuk është marrë nga askush, nuk është kopjuar nga studentët e tjerë dhe asnjë e dhënë në të nuk është burim i pacituar apo referuar.

FALENDERIMET

Ju jemi mirënjohës të gjithëve.

Falënderimi më i sinqert për mentorin e këtij punimi Prof.Ass.Dr Dardan Koqinaj, për përkushtimin, punën, bashkpunimin dhe udhëheqjen profesionale në punimin final të diplomës.

Falenderojmë stafin e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit, Spitalit të Përgjithshëm të Gjakovës për miratimin e kërkesës dhe gjithashtu bashkpunimin në nxerrjen e rezultateve.

Një falënderim shumë i veçant shkon edhe për familjet tona, për kurajon dhe mbështetjen që na kanë ofruar gjatë këtyre viteve të studimeve. Faleminderit që keni qenë pranë nesh në momentet më delikate dhe që treguat besim të pa lëkundur ndaj punës sonë.

PËRMBAJTJE

1. ABSTRAKT	6
2. HYRJA	7
Kujdesi infermieror ndaj pacientëve të moshuar.....	11
3. QËLLIMI I PUNIMIT	14
4. METODOLOGJIA E PUNËS	15
5. REZULTATE.....	16
6. DISKUTIMI.....	34
7. PËRFUNDIMI	35
8. REKOMANDIME.....	36
9. ABSTRACT	37
10. REFERENCA.....	38
11. CV E STUDENTEVE	41
12. SHTOJCA.....	42

1. ABSTRAKT

Plakja progresive fizike shpie në një modifikim të imazhit trupor. Si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në ato në zhvillim familja mbetet burimi parësor i përkujdesit social. Moshimi i popullsisë është kthyer në një nga çështjet më parësore të agjendës botërore.

Qëllimi kryesor i punimit është shtjellimi i tematikës së sfidave të kujdesit ndaj popullatës së moshuar nga perspektiva e infermiereve të punësuar. Në veçanti përballja me përvojat e profesionistëve të punësuar në reparte të ndryshme dhe kushteve për qasje e kujdes të kësaj popullate të moshuar.

Hulumtimi është prospektiv, kualitativ, deskriptiv. Burimi kryesor i të dhënave për realizimin e punimit ka qenë anketa- pytësori i hartuar nga 23 pytje. Në hulumtim kanë marrë pjesë 18 infermier. Prej tyre 9 në Spitalin Rajonal të Prizrenit dhe 9 në Spitalin Rajonal të Gjakovës. Fillimisht për realizimin e punimit është marrë leje nga Drejtoria e Spitalit të Prizrenit dhe Spitalit të Gjakovës, me anë të kërkesës së shkruar nga ne dhe aprovuar nga mentori ynë klinik.

Të gjithë infermieret në intervistë me anë të pytësorit kanë deklaruar se punojnë në institucion të sektorit publik në nivelin e dytë shëndetësor. Infermieret janë përgjigjur se gjatë ofrimit të kujdesit janë has më shumë në pacient të moshuar; pra në të dyja spitalet publike. Infermieret janë përgjigjur se të moshuarit në institucion paraqiten me përcjellës apo i sjellin familjarët në shumicën e rasteve. Infermieret e Spitalit në Prizren kanë deklaruar se në insitucionin e tyre ka shteg për levizje me karrocë si jashtë po ashtu edhe brenda, ndërsa ata në Spitalin e Gjakovës kanë deklaruar se nuk kanë shteg të veçantë për lëvizje me karrocë. Sikurse në Spitalin e Prizrenit po ashtu edhe në Gjakovë, infermieret kanë potencuar se ka lift në institucionin e tyre dhe po ashtu ai është funksional.

Flajë kyçe: të moshuarit, shtëpi pleqsh, kujdes shëndetësor.

2. HYRJA

Evropa po përballet me një sfidë të madhe siç është ajo e popullsisë në plakje. Analiza e më se 46 shteteve evropiane, sa i përket aspektit demografik pasqyron performancën e politikave në tri fusha kryesore përfshirë këtu dhe moshën e popullsisë në vendet e tyre. Moshë mesatare në botë është 73 vjeç, me përjashtim në 83 vjeç në Evropën Perëndimore. Në bazë të raportit rritja e moshës mesatare nuk vjen gjithmonë si pasojë e rritjes së jetëgjatësisë, por si pasojë e një fertiliteti të ulët dhe uljes së numrit të lindjeve. Në shumë vende të Evropës, sidomos asaj Lindore dhe Ballkanit Perëndimor plakja e popullsisë shkaktohet edhe nga emigrimi i grup-moshave të reja, duke ndikuar në uljen e lindjeve dhe rritjen e moshës mesatare të popullsisë. Plakja e popullsisë na jep një dimension tjetër të të kuptuarit të kujdesit shëndetësor, shpenzimeve, pensione, varësisë, skemave sociale, ndikimeve ekonomike dhe fuqisë punëtore, kontradiktat midis brezave. Politika e ndryshme mund të kontribuojnë në përshtatjen ndaj ndryshimeve demografike, duke integruar grupmoshat më të vjetra, por edhe duke nxitur ato më të reja për krijimin e familjeve.¹

Plakja progresive fizike shpie në një modifikim trupor. Për të pranuar ndryshimet që sjell pleqëria, është e rëndësishme të realizohet ekuilibër i potencialeve fizike, psikike, afektive, intelektuale, shpirtërore të vetë pacientit. Procesi i plakjes, është gjithmonë në progres dhe çdo gjë që ndodh në mënyrë të ndryshme nga personi në person, ka lidhshmeri me “të moshuarin e thyeshëm” me zvogëlim të aftësisë mbi veten e tij nga ana fizike dhe psikike. Trashegimia, familja, stili i jetës, ushqyerja, mjedisi (jetesa dhe puna), raportet personale, etj., ndikojnë në mënyrën e plakjes duke realizuar një ndërthurje të faktorëve biologjikë dhe socialë.²

Moshimi është sigurisht një nga sfidat më madhore të shekullit XXI dhe efektet e tij po ndihen në shumë aspekte të jetës individuale dhe kolektive.³Të moshuarit kanë qenë dhe do të mbetën një

¹Carpenter et al. The psychological preferences of older adults: a pilot examination of structure and content. *The Gerontologist*, Vol. 40, No. 3, 2000.

²Zallari, K, Bara. P Bazat e Gerontologjisë dhe të Geriartrisë. Tiranë: Tabernakul; 2006.

³ASAG. (2015). Moshimi, vlerësimi i legjislacionit në Shqipëri. Tiranë, Albpaper. Banville Law. Poor hygiene in nursing homes leads to poor health. Available from: <https://banvillelaw.com/nursing-home-lawsuit/poor-hygiene/>: [Accessed 1st Juny 2017].

fokus kryesor për politikat sociale, kjo edhe për faktin se shumë shtete të botës e shohin gjithnjë e më tepër si kërcënues rritjen e numrit të të moshuarve. Moshimi është proces natyral dhe normal, është një fazë e jetës që karakterizohet nga një rënie e përgjithshme mendore dhe fizike. Në këndvështrimin bio-mjekësor moshimi është një stad në të cilin funksionet biologjike fillojnë të dëmtohen, dëmtohet shikimi, dëgjimi, shija, reagimi ndaj stimujve, etj.⁴Nga një perspektivë tjetër, moshimi është një nga proceset biologjike më komplekse, përkufizimi i të cilit është i lidhur ngushtë me disa ndryshime: demografike, patologjike e psikologjike.⁵Mosha që përkon me daljen në pension në shumë vende të zhvilluara, pretendohet të jetë fillimi i moshës së tretë.⁶Pra, moshimi rezulton të jetë një proces shumë-dimensional pasi përmbledh një shumëllojshmëri ndryshimesh fizike, sociale dhe psikologjike.⁷Familja mbetet burimi kryesor i përkujdesit ndaj të moshuarve, dhe në këtë mes femra zë pozitë qendrore në përkujdesje për çdo gjeneratë. Përkujdesi për të moshuarit ka qenë dhe vazhdon të jetë, edhe pse jo në atë masë si më parë, çështje familjare. Me ndryshimet socio-demografike përkujdesi ndaj të moshuarve është kthyer në një problem me serioz, është i lidhur me ofruesit e shërbimeve për përkujdesje ndaj të moshuarve me pagesë. Në 2030 është parashikuar që do të ketë shtim të përqindjës së të moshuarve mbi moshën 65 vjeç, e cila popullatë do të ndryshojë në një sërë mënyra. Të arriturat në teknologji, në shkencë e në fushën mjekësore kanë ndikuar në jetëgjatësi, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, gjë që terthorazi pastaj ka ndikuar në aspekte tjera të rëndësishme (p.sh. ndërveprimet mes gjeneratave, stili i të jetuarit, etj.).⁸

⁴Bookman, A & Kimbrell, D. Families and elder care in the twenty-first century. Future of Children Organisation. London: Thomas Telford Publishing; 2000.

⁵Cho E, Kim H, Kim J, Lee K, Meghani SH, Chang SJ. Older Adult Residents' Perceptions of Daily Lives in Nursing Homes. Publishing: J Nurs Scholarsh. 2017 Jun 12.

⁶Global Health Statistic. WHO: [Online], Available from: <https://www.who.int/>; [Accessed 2nd August 2015].

⁷School of Nursing. University of Michigan, Allen, K. (2008). Cooperative Learning and Cooperative Pre-Training: An Intervention for Loneliness. [Online]. Available from: <https://nursing.umich.edu/> [Accessed 5th 2008].

⁸Dhëmbo, E. and Agolli, I. Politika Sociale dhe Mirëqenia Sociale:[Online] Social Policy and Social Welfare: Lectures, Essays and Papers. Tiranë [Accessed from 8th February 2010].

Të drejtat e të moshuarve si qenie njerëzore mund të gjinden brenda kornizës së **Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut**.⁹Në Kosovë janë aprovuar Ligji i Shëndetësisë dhe mbi Sigurimin Shëndetësor që po ashtu të moshuarit i vendosin kategori të barabarta me të gjitha kategorite tjera.¹⁰Rëndësia e mjedisit si një faktor që ndikon në jetesën e të moshuarve është theksuar në shumë studime të realizuara ndër vite.Mënyra sesi është ndërtuar mjedisi dhe klima sociale brenda atij mjedisi ka një peshë shumë të madhe në lehtësimin e tranzicionit nga shtëpia në institucion.¹¹ Të moshuarit nuk duan vetëm përkujdesje, ata së pari duan të ndihen si në shtëpi. Klima sociale e krijuar në mjedisin e përkujdesit është gur themeli në mirëqenien e të moshuarve të institucionalizuar që ndikojnë shumë në gjendjen emocionale dhe funksionimin e të moshuarve.¹²Te mjedisi i rehatshëm të moshuarit ndjejnë më pak vetmi dhe përjetojnë më pak depresion. Ndërtimi i dhomave në mënyrë që të respektojnë (privatësinë) e të moshuarve ndikon në mirëqenien e të moshuarve.¹³Individët janë të prirur që të moshohen në të njëjtin vend, pra të moshohen në vendin në të cilin ata kanë qenë të përshtatur (emocionet) dhe jo të lëvizin drejt institucioneve të specializuara. Qëndrimet e të moshuarve ndaj qendrave të përkujdesit përmirësohen sidomos në rastet kur ata ndihen të vetmuar dhe nuk kanë marrëdhënie sociale me persona të tjerë. Këtu patjetër se duhet të mos harrohet fakti se Institucioneve të përkujdesit (për

⁹Universal Declaration of Human Rights: [Online]. Available from: <http://www.un.org/en/> [Accessed from 17th September 1948] Paris.

¹⁰Karta Sociale Europiane, [Online] Strasburg 2007, Available from: <https://rm.coe.int/> [Accessed from 3th May 1996].

¹¹Stokols, D., & Shumaker, S. A. (1981). People in places: A transactional view of settings. In J. H. Harvey (Ed.), *Cognition, social behavior, and the environment* (pp. 441–488). Publishing: Hillsdale, NJ: Erlbaum.

¹²Meyers S. Role of the social worker in old versus new culture in nursing homes. Publishing: Soc Work. 2006;51(3):273-7.

¹³Stokols, D., & Shumaker, S. A. (1981). People in places: A transactional view of settings. In J. H. Harvey (Ed.), *Cognition, social behavior, and the environment* (pp. 441–488). Publishing: Hillsdale, NJ: Erlbaum.

të moshuarit) i jepet vlerë negative gjë e cila vështireson dakordimin apo përshtatjen e të moshuarit me vendbanimin e ri¹⁴ me apo pa mundësinë në vendimarrje.¹⁵

Sa i përket aspektit social, Institucionet tentojnë të krijojnë një kulturë sipas së cilës të moshuarit, familjarët dhe individët e tjerë nxiten për të zhvilluar marrëdhënie sociale pozitive, të ndërveprojnë dhe të eksplorojnë idetë e tyre së bashku.¹⁶Marrëdhëniet sociale pozitive mundësojnë që stafi të adresojë më mirë nevojat e të moshuarve, të komunikojnë drejtë, të marrin vendim. Fakti që të moshuarit vështirë e ndërrojnë vendin e tyre të qëndrimit e banimit, dhe që ata vështirë e pranojnë përkujdesjen në Institucion, aktivitetet rekreative mendohet se këtë situatë tentojnë ta zbusin deri në një masë. Kjo mendohet se ka ndikim edhe në kënaqësinë e të moshuarve. Nga ana tjetër aktivitetet krijojnë mundësinë për kontakte sociale. Ekziston një numër shumë i madh aktivitetesh rekreative në të cilat mund të përfshihen të moshuarit, të tilla si: sporti, udhëtimet, arti etj. Përkunder realitetit ku ata në të shumten e rasteve përfshihen në aktivitete si leximi i gazetave, shikimi i televizionit, etj. që më tepër janë pasive dhe individuale. Depresioni është një gjëndje shëndetësore serioze në të gjitha moshat, po tek të moshuarit ai rëndohet pasi kombinohet edhe me disa faktorë si, ndërrimi i vendbanimit, kushteve të jetës, shmangia nga familjarët, mos kontakti me të dashurit, të afërmit.^{17,18}Depresioni manifestohet nëpërmjet: rënies së interesit për aktivitete, mungesë përqendrimi, irritim, probleme me gjumin, humbje të oreksit e të tjera si këto.

¹⁴Wahl, H.W, G.D. Weisman et al. Environmental gerontology at the beginning of new millennium: Reflections on its historical, empirical, and theoretical development. The Gerontologist [Online] 2003 43(5): 612–627 Available from: <https://academic.oup.com/> . [Accessed 1st October 2003].

¹⁵Rubinstein, R. L. Personal identity and environmental meaning in later life. Journal of Aging Studies [Online] 1990; 4, 131–148. Available from DOI: [10.1016/0890-4065\(90\)90011-V](https://doi.org/10.1016/0890-4065(90)90011-V) [Accessed 26th September 2000].

¹⁶J T Arokiasamy, SM, Department of Social and Preventive Medicine, Faculty of Medicine, University of Malaya, Kuala Lumpur. Social Problems and Care of the Elderly. Journal of Global Theme Issue [Online] 1997; [Accessed 3thSeptember].

¹⁷Nolan, M. R., Brown, J., Davies, S., Nolan, J. And Keady, J. The Senses Framework: improving care for older people through a relationship-centred approach. Getting Research into Practice (GRiP) Report No 2.

¹⁸Tercan E. World Conference on Learning, Teaching and Educational Leadership in Antalya, Turkey. An Examination of Leisure Participation, Family Assessment and Life Satisfaction in University Students. [Online] 2015; 186:58-63. Available from: DOI: [10.1016/j.sbspro.2015.04.123](https://doi.org/10.1016/j.sbspro.2015.04.123). [Accessed 5th May 2015].

Izolimi social është një fenomen objektiv, i cili mund të matet duke vëzhguar interaksionin dhe rrjetin e marrëdhënieve sociale.¹⁹ Kështu izolimi është humbja e një pozicioni brenda vetë grupit të personit. Dallohet izolimi nga komuniteti, izolimi organizativ (nga shkolla, puna, institucionet etj.), izolimi pranë personit dhe brenda personit. Në moshën e tretë, së bashku me rënien fizike, psikologjike, emocionale dhe ndërrimin e roleve, gjejmë edhe prishjen e marrëdhënieve sociale dhe rritjen e izolimit social.²⁰ Imazhi i të moshuarve dhe respekti vazhdimisht kanë ndryshuar.²¹ Mungesa e respektit ndaj të moshuarve është një fenomen i pranishëm në të gjitha shoqëritë, lidhet me pamundësinë e individëve që të kryejnë asnjë funksion në shoqëri. Sipas OBSH mungesa e respektit është një nga format më të thjeshta të abuzimit.²²

Kujdesi infermieror ndaj pacientëve të moshuar

Etika ka të bëjë më mënyrën se të moshuarit duan të trajtohen dhe të lejohen të bëjnë vendimet e tyre. Të moshuarit shpesh kanë nevojë komplekse shëndetësore.²³ Staf i infermieror për pacientët e moshuar duhet të jenë të edukuar për të kuptuar dhe trajtuar nevojat shpesh komplekse fizike dhe të shëndetit mendor për të ndihmuar pacientët për të mbrojtur shëndetin dhe të përballen me

¹⁹British Columbia Ministry of Health, [Online] 2004. Statistics Canada information is used with the permission of the Minister of Industry, as Minister responsible for Statistics Canada. Information on the availability: Statistics Canada can be obtained from Statistic's Canada's Regional Offices, its World Wide Web site at <http://www.statcan.ca>.

²⁰Hooyman NR, Kiyak HA. Social Gerontology: A multidisciplinary perspective (3rd ed). Allyn and Bacon, Boston, 1993.

²¹Leong WK. Efforts to strengthen the bonds of the elderly in the family and community. Journal of the Malaysian Society of Health, 1985;5(1) : 55-60.

²²Tam, Sandra; Neysmith, Sheila-Disrespect and Isolation: Elder Abuse in Chinese Communities, Canada 2006.

²³Lee KS, Owen RE, Choo PWJ, Jayaratnam FJ. Prevention in Geriatric Medicine. Singapore Med. J 1990;31 : 619-20.

ndryshimet në aftësitë e tyre mendore dhe fizike, në mënyrë që të moshuarit mund të qëndrojnë të pavarur dhe aktivë për aq kohë sa të jetë e mundur.

Infermieri / ja duhet të angazhohet në marrëdhëniet funksionale me pacientin dhe atë: të jetë i pranishëm, të ofroj shpjegime, të interesohet për klientin/ pacienti, të përgjigjet qartë dhe saktë, të kujdeset mbi higjienën, mbështetëse marrëdhëniet sociale dhe familjare, të tregoj tolerancë e mirëkuptim për përkatesinë etnike dhe fetare, të veproj me respekt e në mënyrë të dinjitetshme, të ofrojë mbështetje, të shërbej pa përfitime.

Gjatë punës me pacientët e moshuar, duhet: të vlerësojë gjëndjen mendore të pacientit dhe (të menduarit) aftësitë njohëse; kuptojë gjendjet akute dhe kronike; mbështetëse për shqetësimet e (shëndetësore) dhe gjatë përdorimit të medikamenteve; ofrojë në vazhdimësi edukimin e pacientit; ndihmojnë lëvizjen, transferin; realizojnë të ushqyerit; të kujdesen për higjienën; përkrahin bashkëpunimin.²⁴

Infermierët luajnë një rol integral në menaxhimin dhe kujdesin e pacientëve të moshuar. Çështjet që ndikojnë në rritjen e cilësisë për kujdesin dhe sigurinë e pacientit janë: Cilësia dhe performanca; Administrimi i shërbimeve infermiore; Menaxhimi infermior; Standardet profesionale infermiore dhe Procesi infermior dhe komunikimi.

Cilësia është produkt i dëshirës njerëzore. Cilësia mund të matet nga jashtë, por përmirësohet vetëm nga brenda prej njerëzve që e dëshirojnë atë. Thelbi i cilësisë janë: njerëzit, pasioni, dedikimi. Cilësia është bërja e gjërave të duhura, në kohën e duhur dhe në mënyrën e drejtë.

Administrimi i shërbimeve infermiore është proces i planifikimit, organizimit, udhëheqjes dhe kontrollimit të resurseve humane, materiale, financiare dhe informative që lidhen me mënyrën organizative të punës në arritjen e objektivave të paradefinuar.

Menaxhimi thjeshtë mund t'i referohet procesit të cilin ekipi menaxhues e ndjek për të përmbushur qëllimet organizative. Menaxhimi i mirë shëndetësor gjithmonë zgjedh shkathtësitë,

²⁴Lynda Juall Carpenito [Online] London: Lippincott Williams & Wilkins Publishing; 2016 Available from <https://www.ebay.com/p/Handbook-of-Nursing-Diagnosis> [Accessed 8th March 2016]

jo personat. Shkathësitë për menaxhim të mirë shëndetësor: - komunikimi efektiv, - shkathësi efektive të konceptimit, - krijimi i ekipit të punës.

Standardet profesionale infermiore²⁵ janë qëndrimet rreth niveleve të performancës që kërkohet nga infermierët të arrijnë në praktikën e tyre në kujdesin dhe sigurinë e pacientit. Ata duhet të: reflektojnë vlerat e profesionit të infermierisë, sqarojnë atë që profesioni pret prej tyre, kuptojnë më mirë obligimet e tyre profesionale, përkrahin kompetencën e tyre të vazhdueshme dhe zhvillimin profesional, avokojnë për ndryshime në politikë dhe praktikë, definojnë dhe zgjidhin problemet profesionale të praktikës, përfshihen në kurset dhe programet edukative për infermieri.

Procesi infermior është një procedurë që ndërtohet nga vetë i sëmurë dhe zbatohet nga infermierja dhe ekipi i kujdesit. Procesi i kujdesit infermior dhe sigurimi i pacientit (të menduarit kritik) përfshinë: ekzaminimin, diagnozën infermiore, planifikimin, zbatimin, vlerësimin. Komunikimi kryen një rol shoqëror dhe më pas përkrah një person të sëmurë, duke ndërtuar dhe ruajtur rolin e marrëdhënieve staf infermior – pacient. Komunikimi i mirë mes infermierëve dhe pacientëve është thelbësor për arritjen e rezultateve të suksesshme të kujdesit infermior.²⁶ Komunikimi është i rëndësishëm për pacientin sepse rrit tek ai kënaqësinë dhe diturinë, ul ankthin dhe shqetësimin, ndihmon dhe lehtëson marrjen e vendimeve dhe përballimin. Pikënisja ose burimi i komunikimit duhet të jetë prestigjioz i besueshëm.

²⁵Reed J, Clarke Ch, MacFarlane A., Nursing Older Adults [Online]: Open University Press Publishing; Available from: <https://www.amazon.com/> [Accessed 1st ed. August 2011].

²⁶Ornela Xhangolli Dervishi “Komunikimi infermier-pacient, thelbësor për një shërbim efektiv”, Tiranë, 2015.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi kryesor i punimit është shtjellimi i tematikes se sfidave të kujdesit ndaj popullatës së moshuar nga perspektiva e infermiereve të punësuar. Në veçanti përballja me përvojat e profesionistëve të punësuar në reparte të ndryshme dhe kushteve për qasje e kujdes të kësaj popullate të moshuar.

4. METODOLOGJIA E PUNËS


Hulumtimi është prospektiv, kualitativ, deskriptiv. Burimi kryesor i të dhënave për realizimin e punimit ka qenë anketa- pytësori i hartuar nga 23 pyetje. Në hulumtim kanë marrë pjesë 18 infermier. Prej tyre 9 në Spitalin Rajonal të Prizrenit dhe 9 në Spitalin Rajonal të Gjakovës. Fillimisht për realizimin e punimit është marrë leje nga Drejtoria e Spitalit të Prizrenit dhe Spitalit të Gjakovës, me anë të kërkesës së shkruar nga ne dhe aprovuar nga mentori ynë klinik.

5. REZULTATE

Prezentimi i rezultateve është bërë në dy pjesë. Në pjesën fillestare janë të dhënat e përgjithshme të profesionisteve të anketuar, gjinia, pjesmarrja sipas Institucioneve ku janë të punësuar, reparteve e kategorisë së popullatës për të cilën kujdesen. Pastaj në vazhdim janë rezultatet e fituara nga anketimi përmes pyetjeve të lidhur me kujdesin dhe qasjen e pacienteve të cilët kërkojnë ndihmë ose kanë nevojë për përkujdesje në Institucionet përkatës.

Tabela 1. Paraqitja e personelit shëndetësor të anketuar sipas gjinisë për Spitaline Prizrenit dhe të Gjakovës.

Gjinia	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
Femër	6	66,67	5	55,56
Mashkull	3	33,33	4	44,44
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 1.Paraqitja e personelit shëndetësor të anketuar sipas gjinisë për Spitalin e Prizrenit dhe të Gjakovës.

Më lartë në tabelen dhe grafikunin numër 1 janë paraqitur rastet sipas gjinisë në Spitalin e Prizrenit dhe të Gjakovës. Në Spitalin e Prizrenit ishin 6 femra apo 66,67% dhe 3 meshkuj apo 33,33%, kurse në Spitalin e Gjakovës ishin 5 femra apo 55,56% dhe 4 meshkuj apo 44,44%.

Tabela 2. Moshë e infermiereve të intervistuar në Spitalin e Prizrenit dhe Spitalin e Gjakovës

Moshë	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
30-33	1	11,11	1	11,11
34-37	1	11,11	3	33,34
38-40	1	11,11	1	11,11
Mbi 40 vjeç	2	22,22	2	22,22
Pa identifikuar	4	44,45	2	22,22
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 2. Mosha e Infermiereve të intervistuar në Spitalin e Prizrenit dhe Spitalin e Gjakovës

Në grafikonin dhe tabelen 2 janë paraqitur rastet sipas moshës në të dy spitalet. Në Spitalin e Prizrenit më së shumti ishin individ apo infermier të paidentifikuar në moshë 4 apo 44,45%, mbi 40 vjeç ishin 2 infermierë apo 22,22%, dhe nga mosha 30-33, 34-37, 38- 40 ishin nga një infermierë apo nga 11,11% gjithsecila alternative. Përderisa në Spitalin e Gjakovës grupmosha me e prezentuar në mesin e të anketuarve ishte ajo 34-37 vjeçare me 33.34%.

Tabela 3. Në pyetjen: Ne cilin sektor jeni të punësuar?

Sektori	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
Publik	9	100,00	9	100,00
Privat	0	0	0	0
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 3. Në pyetjen: Në cilin sektor jeni të punësuar?

Pasi që vetë pytëtori është shpërndarë në sektorin apo nivelin sekondar, të gjithë infermierët nga të dy spitalet janë përgjigjur për sektorin publik, gjithsej 9 apo 100,00%

Tabela 4. Në pyetjen: Në cilin nivel jeni i/e punësuar?

Nivelet e shërbimit shëndetësorë	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
Primar – Mjekësi familjare	0	0	0	0
Sekondar – Spital	9	100,00	9	100,00
Terciar - QKUK	0	0	0	0
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 4. Në pyetjen: Në cilin nivel jeni i/e punësuar?

Edhe në tabelen dhe grafikonin 4 vlen të ceket se pytësori është shpërndarë në nivelin sekondar dhe të gjithë infermierët nga të dy spitalet janë përgjegjgur që punojnë në nivelit sekondar shëndetësor, gjithsej 9 apo 100,00%

Tabela 5. Në pyetjen: Nëse punoni në nivelin sekondar ose terciar në cilin repart punoni?

Reparti/	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
Mjekim intensiv qendror	2	22,23	0	0
Interno	4	44,44	3	33,33
Kirurgji	1	11,11	3	33,33
Neurologji	1	11,11	2	22,23
Pa përgjigje	1	11,11	1	11,11
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 5. Në pyetjen: Nëse punoni në nivelin sekondar ose terciar në cilin repart punoni?

Në tabelen dhe grafikonin 5 janë përgjigjur infermierët se në cilat reparte punojnë, dhe në bazë të një renditje kemi hasur se në Spitalin e Prizrenit 1 nga infermierët nuk është përgjigjur 11,11%, 1 apo 11,11% punon në neurologji, 1 apo 11,11% në kirurgji, 4 apo 44,44% në interno dhe mjekim intenziv qëndror 2 apo 22,23%. Kurse, në Spitalin e Gjakovës 1 apo 11,11% pa përgjigje, 2 nga ta punonin në neurologji apo 22,23%, në kirurgji 3 apo 33,33%, në interno 3 apo 33,33%.

Tabela 6. Në pyetjen: Me cilin grupacion të popullatës punoni më tepër gjatë punës së përditshme:

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
Fëmijë	0	0	0	0
Adult	2	22,22	1	11,11
Femra	0	0	0	0
Të moshuar	7	77,78	8	88,89
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 6. Në pyetjen: Me cilin grupacion të popullatës punoni më tepër gjatë punës së përditshme

Në tabelen më lartë dhe grafikonin 6 janë paraqitur edhe grupacioni i popullatës që infermierët punojnë me ta. Në spitalin e Prizrenit dominon mosha e tret apo të moshuarit me 7 apo 77,78%, pastaj janë fëmijët me 2 apo 22,22%. Ndërsa në Spitalin e Gjakovës prap dominojnë të moshuarit me 8 apo 88,89% dhe pastaj adultët me 1 apo 11,11% nga gjithsej 9.

Tabela 7. Në pyetjen: A kanë përcjellës të moshuarit që kërkojnë shërbim?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
Me përcjellës	6	66,67	7	77,78
Pa përcjellës	3	33,33	2	22,22
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 7. Në pyetjen: A kanë përcjellës të moshuarit që kërkojnë shërbim?

Në grafikonin dhe tabelen 7 janë paraqitur rastet e pacienteve me dhe pa përcjellje. Në Spitalin e Prizrenit 6 janë raportuar se vin me përcjellës apo 66,67% dhe 3 apo 33,33% pa përcjellës. Në Spitalin e Gjakovës 7 apo 77,78% nga infermierët kanë deklaruar se të moshuarit apo pacientën vin me përcjellës dhe 2 kanë thënë pa përcjellës apo 22,22%.

Tabela 8. Në pyetjen: A ekziston shtegu i veçuar për lëvizje me karrocë pranë hyrjes në institucionin tuaj?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	8	88,89	2	22,22
JO	1	11,11	7	77,78
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 8. Në pyetjen: A ekziston shtegu i veçuar për lëvizje me karrocë pranë hyrjes në Institucionin tuaj?

Në pyetjen se e ekziston shtegu për karrocë në institucionin tuaj në Spitalin e Prizrenit, 8 infermier kanë thënë që po apo 88,89% dhe jo është përgjigjur vetëm 1 apo 11,11%. Në Spitalin e Gjakovës 2 nga infermieret janë përgjigjur jo apo 22,22% dhe 7 janë përgjigjur me po apo 77,78%.

Tabela 9. Në pyetjen: A ekziston shtegu i veçuar për lëvizje me karrocë në (brenda) Institucionin tuaj?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	7	77,78	3	33,33
JO	2	22,22	6	66,67
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 9. Në pyetjen: A ekzistonë shtegu i veçuar për lëvizje me karrocë në (brenda) Institucionin tuaj?

Në vazhdim në pyetjen se a ekziston shtegu për karroc brenda institucionit në Spitalin e Prizrenit 7 apo 77,78% janë përgjigjur me po, 2 apo 22,22% me jo. Në Spitalin e Gjakovës 3 apo 33,33% janë përgjigjur me po dhe 6 apo 66,67% me jo.

Tabela 10. Në pyetjen: A ka institucioni juaj lift (ashensorë)?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	8	88,89	9	100,00
JO	1	11,11	0	0
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 10. Në pyetjen: A ka institucioni juaj lift (ashensorë)?

Në tabelen dhe grafikonin 10 janë paraqitur përgjigjet e pyetjes se a ka institucioni juaj lift. Në Spitalin e Prizrenit 8 nga infermieret kanë thënë Po apo 88,89%, dhe 1 apo 11,11% ka thënë Jo. Në Spitalin e Gjakovës të gjithë nga infermieret e intervistuar përmes pyëtësorit gjithsej 9 apo 100,00% kanë deklaruar me po.

Tabela 11. Në pyetjen: A është lifti (ashensori) funksional?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	8	88,89	9	100,00

JO	1	11,11	0	0
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 11. Në pyetjen: A është lifti (ashensori) funksional?

Në grafikonin në vazhdim, në Spitalin e Prizrenit 8 nga infermierët apo 88,89% kanë thënë që Po ashensori është funksional dhe 1 nga ta është përgjigjur Jo 11,11%. Në Spitalin e Gjakovës të gjithë nga infermierët janë përgjigjur me PO 9 apo 100,00%.

Tabela 12. Në pyetjen: A ka në qytetin tuaj Shtëpi të Pleqve?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	0	0	0	0
JO	9	100,00	8	88,89
Nuk e di	0	0	1	11,11
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 12. Në pyetjen: A ka në qytetin tuaj Shtëpi të Pleqve?

Nga pyetja në vazhdim se a ka në qytetin tuaj shtëpi për të moshuar, në Spitalin e Prizrenit të gjithë infermierët 9 apo 100,00% deklaruar se Jo nuk ka, kurse në Spitalin e Gjakovës 8 u përgjigjen me Jo apo 88,89% dhe 1 me Nuk e di 11,11%.

Tabela 13. Në pyetjen: A ka në qytetin tuaj ndonjë aktivitet për të moshuarit?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	0	0	0	0
JO	7	77,78	6	66,67
Nuk e di	2	22,22	3	33,33
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 13. Në pyetjen: A ka në qytetin tuaj ndonjë aktivitet për të moshuarit?

Në grafikonin dhe tabelen 13 janë përgjigjet e infermiereve për aktivitetin e të moshuarve në qytet. Në Spitalin e Prizrenit 7 infermier apo 77,78% kanë thënë JO, dhe 2 nga ta me Nuk e di apo 22,22%. Në Spitalin e Gjakovës 6 infermier apo 66,67% kanë thënë Jo dhe 3 Nuk e di 33,33%.

Tabela 14. Në pyetjen: A ka në qytetin tuaj ndonjë lehtësi për të moshuarit?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	1	11,12	0	0
JO	4	44,44	5	55,56
Nuk e di	4	44,44	4	44,44
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 14. Në pyetjen: A ka në qytetin tuaj ndonjë lehtësi për të moshuarit?

Nga tabela dhe grafikoni 14 kemi përgjigjet për ndonjë lehtësi për të moshuarit. Në Spitalin e Prizrenit 1 infermier ka thënë PO apo 11,12%, 4 janë përgjigjur me Jo 44,44% dhe 4 me Nuk e di 44,44%.

Në Spitalin e Gjakovës 5 nga infermieret janë përgjigjur me Jo apo 55,56% dhe 4 nga ta apo 44,44% me Nuk e di.

Tabela 15. Në pyetjen: A duhet që pacienti t'i siguroj (blej) vet medikamentet?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	7	77,78	6	66,67
JO	1	11,11	2	22,22
Pa përgjigje	1	11,11	1	11,11
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 15. Në pyetjen: A duhet që pacienti t'i siguroj (blej) vet medikamentet?

Në grafikonin dhe në tabelen në vazhdim shohim se në Spitalin e Prizrenit 7 infermier janë përgjigjur me PO (pacienti i siguron apo i blen vet medikamentet) apo 77,78%, 1 apo 11,11% me Jo dhe 1 apo 11,11% pa përgjigje. Ndërsa në Spitalin e Gjakovës 6 infermier janë përgjigjur me Po 66,67%, 2 me Jo apo 22,22%, dhe 1 apo 11,11% pa përgjigje.

Tabela 16. Në pyetjen: A keni të moshuar në familje?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	Numri	Përqindje	Numri	Përqindje
PO	8	88,89	5	55,56
JO	1	11,11	4	44,44
Gjithsej	9	100,00	9	100,00




Grafikoni 16. Në pyetjen: A keni të moshuar në familje?

Në grafikonin e 16 dhe në përgjigjet e pytyës se a keni të moshuar në shtëpi në Spitalin e Prizrenit 8 infermier janë përgjigjur me Po 88,89% dhe 1 me Jo apo 11,11%. Në Spitalin e Gjakovës 5 infermier janë deklaruar se Po apo 55,56% dhe 4 apo 44,44% me Jo.

Tabela 17. Në pyetjen: Gjatë përvojës të punës suaj profesionale, a keni ofruar ndonjëherë ndihmë (kujdes, terapi, injeksione, këshilla, etj) në shtëpi të moshuarit?

	Spitali i Prizrenit		Spitali i Gjakovës	
	N	%	N	%
PO	5	55,56	6	66,67
JO	3	33,33	2	22,22
Pa përgjigje	1	11,11	1	11,11
Gjithsej	9	100,00	9	100,00



Grafikoni 17. Në pyetjen: Gjatë përvojës të punës suaj profesionale, a keni ofruar ndonjëherë ndihmë (kujdes, terapi, injeksione, këshilla, etj) në shtëpi të moshuarit?

Nga pyetja në vazhdim se gjatë përvojës a keni dhënë kujdes për të moshuarit, këshillë, etj në Spitalin e Prizrenit 5 apo 55,56% kanë raportuar se Po, Jo kanë raportuar 3 apo 33,33% dhe 1 ka qenë pa përgjigje 11,11%.

Në Spitalin e Gjakovës 6 apo 66,67s% e infermiereve kanë deklaruar se Po kanë ofruar kujdes, këshilla e etj, 2 apo 22,22% me Jo dhe pa përgjigje ka qenë vetëm 1 apo 11,11%.

6. DISKUTIMI

Rëndësia e faktorëve të mjedisit në mirëqenien e të moshuarve është theksuar nga shumë studime dhe ka marrë vëmendjen edhe të shumë kërkuesve të shkencave sociale. Një studim te të moshuarite moshës mbi 60 vjeç në Brazil tregon se arsyet e ardhjes së të moshuarve në këto qendra përfshinin ndjenjën e përjashtimit, dhimbjen e të qenit i përjashtuar, besimin që ata janë kthyer në barrë për familjen e tyre, vetminë, mungesën e respektit dhe vlerësimit nga ana e familjarëve etj.

²⁷

Nga rezultatet e fituara nga infermierët në studimin tonë, u vërejt se kishim të bëjmë me profesionistë të cilët kryesisht mirreshin me kujdes ndaj të moshurave të cilët vinin nga reparte të ndryshme, në të cilat përballeshin me nevojat e përditshme, aktuale të kësaj kategorie. Poashtu u tregua se të moshuarit vijnë me përcjellës dhe se ka vend për përmirësim të kujdesit përshirë edhe infrastrukturën që është masë e nevojshme për këtë kategori të popullatës. Një pjesë e infermiereve të anketuar kishin kryer shërbimet e tyre edhe në shtëpitë e të moshuarve që tregon se nevojat e tyre janë përtej hopsitalizimit.

²⁷Heloísa B.A. Evangelista, Sidinei Magela Thomaz and Cristiane Akemi Umetsu, An analysis of publications on invasive macrophytes in aquatic ecosystems, 4 December 2013 / Accepted: 20 August 2014 / Published online: 1 October 2014.

7. PËRFUNDIMI

- Hulumtimi nxorri në pah se në të dy institucionet: Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit dhe Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, intervistimet me infermier kanë dhënë rezultatet të ngjashme.
- Të gjithë infermierët e anketuar punonin në institucion të sektorit publik në nivelin e dytë shëndetësor.
- Infermieret janë përgjegjur se gjatë ofrimit të kujdesit kanë has më shumë në pacientë të moshuar; në të dyja spitalet publike.
- Infermieret janë përgjegjur se të moshuarit në institucion paraqiten me përcjellës apo i sjellin familjarët në shumicën e rasteve.
- Infermierët e Spitalit në Prizren kanë deklaruar se në insitucionin e tyre ka shteg për lëvizje me karrocë si jasht po ashtu edhe brenda, ndërsa infermieret në Spitalin e Gjakovës kanë deklaruar se nuk kanë shteg të veçante për lëvizje me karrocë.
- Sikurse në Spitalin e Prizrenit po ashtu edhe në Gjakovë, infermieret kanë potencuar se ka lift në institucionin e tyre dhe po ashtu ai është funksional.
- Në të dy spitalet infermierët kanë deklaruar se në qytet nuk ka shtëpi të pleqëve si dhe ata nuk dijnë për ndonjë aktivitet apo lehtësim që është bërë për të moshuarit.
- Infermierët në të dy spitalet, me përqindje më të madhe kanë deklaruar se të moshuarit vet i blejnë medikamentet e tyre për arsye se shumica nuk gjinden në institucionet tona.
- Infermieret në Prizren pjesa dërmuese kanë thënë se kanë të moshuar në familje si dhe jetojnë bashk me ta, për dallim nga infermieret e Gjakovës ku të gjithë janë raportuar se kanë të moshuar në familje mirëpo vetem gjysma e tyre janë përgjegjur se jetojnë me të moshuarit në shtëpi.
- Si dhe gjatë përvojës si infermier, po thuhet se të gjithë kanë hasur me të moshuar, me kujdes për ta, dhënie të terapisë, këshillave, sugjerime etj.

8. REKOMANDIME

- Ballafaqimin me problematikat e të moshuarve;
- Kujdesin e shëndetshëm dhe të sigurtë;
- Identifikimin e nevojave të të moshuarve;
- Kujdesi për ushqimin e shëndetshëm;
- Kujdesi për terapinë e rregullt dhe adekuate;
- Kujdesi për mirëqenjen e tyre emocionale;
- Krijimi i shtëpive për të moshuar;
- Edukimi i të gjithë aktereve me aspekte të kujdesit ndaj të moshuarve;
- Përfshirja e familjarëve në vizita e kujdes për të moshuarit;
- Trajnimi i vazhdueshem profesional;
- Motivimi dhe inkorporimi i të moshuarve në aktivitetete.

9. ABSTRACT

Progressive physical aging leads to a modification of the bodily image. Both in developed and developing countries, the family remains the primary source of social care. The aging of the population has become one of the priority issues of the world agenda.

The main purpose of the paper is to elaborate on the topic of care challenges for the elderly population from the perspective of employed nurses. In particular, confronting the experiences of professionals employed in different departments and the conditions for access and care of this elderly population.

The research is prospective, qualitative, descriptive. The main source of data for the implementation of the work was the questionnaire prepared by 23 inquiries. 18 nurses participated in the research. Of them 9 in Prizren Regional Hospital and 9 in Gjakova Regional Hospital. Initially, for the realization of the work, permission was issued from the Directorate of Prizren Hospital and Gjakova Hospital, by request written by us and approved by our clinical mentor.

All nurses in the interview with the questionnaire stated that they work in a public sector institution at the second level of health care. Nurses have responded that during the delivery of care they are more likely to get older in the patient; so in both public hospitals. Nurses have responded that elderly people in the institution presented with followers or bring their family members in most cases. The nurses of the Hospital in Prizren have stated that in their institution there are paths for wheelchairs both inside and outside, while those in the Gjakova Hospital have stated that they have no special pathway for wheelchair. As in the Prizren Hospital as well as in Gjakova, nurses have been able to have elevators in their institution and it is also functional.

Keywords: the elderly, nursing home, health care.

10.REFERENCA

1. Carpenter et al. The psychological preferences of older adults: a pilot examination of structure and content. *The Gerontologist*, Vol. 40, No. 3, 2000.
2. Zallari. K, Bara. P Bazat e Gerontologjisë dhe të Geriartrisë. Tiranë: Tabernakul; 2006.
3. ASAG. (2015). Moshimi, vlerësimi i legjislacionit në Shqipëri. Tiranë, Albpaper. Banville Law. Poor hygiene in nursing homes leads to poor health. Available from: <https://banvillelaw.com/nursing-home-lawsuit/poor-hygiene/> : [Accessed 1st Juny 2017].
4. Bookman, A & Kimbrell, D. Families and elder care in the twenty-first century. Future of Children Organisation. London: Thomas Telford Publishing; 2000.
5. Cho E, Kim H, Kim J, Lee K, Meghani SH, Chang SJ. Older Adult Residents' Perceptions of Daily Lives in Nursing Homes. Publishing: J Nurs Scholarsh. 2017 Jun 12.
6. Global Health Statistic. WHO: [Online], Available from: <https://www.who.int/> [Accessed 2nd August 2015].
7. School of Nursing. University of Michigan, Allen, K. (2008). Cooperative Learning and Cooperative Pre-Training: An Intervention for Loneliness. [Online]. Available from: <https://nursing.umich.edu/> [Accessed 5th 2008].
8. Dhëmbo, E. and Agolli, I. Politika Sociale dhe Mirëqenia Sociale:[Online] Social Policy and Social Welfare: Lectures, Essays and Papers. Tiranë [Accessed from 8th February 2010].
9. Universal Declaration of Human Rights: [Online]. Available from: <http://www.un.org/en/> [Accessed from 17th September 1948] Paris.
10. Karta Sociale Europiane, [Online] Strasburg 2007, Available from: <https://rm.coe.int/> [Accessed from 3th May 1996].
11. Stokols, D., & Shumaker, S. A. (1981). People in places: A transactional view of settings. In J. H. Harvey (Ed.), *Cognition, social behavior, and the environment* (pp. 441–488). Publishing: Hillsdale, NJ: Erlbaum.

12. Meyers S. Role of the social worker in old versus new culture in nursing homes. Publishing: Soc Work. 2006;51(3):273-7.
13. Stokols, D., & Shumaker, S. A. (1981). People in places: A transactional view of settings. In J. H. Harvey (Ed.), Cognition, social behavior, and the environment (pp. 441–488). Publishing: Hillsdale, NJ: Erlbaum.
14. Wahl, H.W, G.D. Weisman et al. Environmental gerontology at the beginning of new millennium: Reflections on its historical, empirical, and theoretical development. The Gerontologist [Online] 2003 43(5): 612–627 Available from: <https://academic.oup.com/> . [Accessed 1st October 2003].
15. Rubinstein, R. L. Personal identity and environmental meaning in later life. Journal of Aging Studies [Online] 1990; 4, 131–148. Available from DOI: [10.1016/0890-4065\(90\)90011-V](https://doi.org/10.1016/0890-4065(90)90011-V) [Accessed 26th September 2000].
16. J T Arokiasamy, SM, Department of Social and Preventive Medicine, Faculty of Medicine, University of Malaya, Kuala Lumpur. Social Problems and Care of the Elderly. Journal of Global Theme Issue [Online] 1997; [Accessed 3th September].
17. Nolan, M. R., Brown, J., Davies, S., Nolan, J. And Keady, J. The Senses Framework: improving care for older people through a relationship-centred approach. Getting Research into Practice (GRiP) Report No 2.
18. Tercan E. World Conference on Learning, Teaching and Educational Leadership in Antalya, Turkey. An Examination of Leisure Participation, Family Assessment and Life Satisfaction in University Students. [Online] 2015; 186:58-63. Available from: DOI: 10.1016/j.sbspro.2015.04.123. [Accessed 5th May 2015].
19. British Columbia Ministry of Health, [Online] 2004. Statistics Canada information is used with the permission of the Minister of Industry, as Minister responsible for Statistics Canada. Information on the availability of the wide range of data from Statistics Canada can be obtained from Statistic’s Canada’s Regional Offices, its World Wide Web site at <http://www.statcan.ca> , access number 1-800-263-1136.

20. Hooyman NR, Kiyak HA. Social Gerontology: A multidisciplinary perspective (3rd ed). Allyn and Bacon, Boston, 1993.
21. Leong WK. Efforts to strengthen the bonds of the elderly in the family and community. Journal of the Malaysian Society of Health, 1985;5(1) : 55-60.
22. Tam, Sandra; Neysmith, Sheila-Disrespect and Isolation: Elder Abuse in Chinese Communities, Canada 2006.
23. Lee KS, Owen RE, Choo PWJ, Jayaratnam FJ. Prevention in Geriatric Medicine. Singapore Med. J 1990; 31 : 619-20.
24. Lynda Jull Carpenito, Handbook of Nursing Diagnosis [Online] London: Lippincott Williams & Wilkins Publishing; 2016. Available from <https://www.ebay.com/> [Accessed 8th March 2016]
25. Reed J, Clarke Ch , MacFarlane A,. Nursing Older Adults [Online]: Open University Press Publishing; Available from: <https://www.amazon.com/> [Accessed 1st ed. August 2011].
26. Ornela Xhangolli Dervishi “Komunikimi infermier-pacient, thelbësor për një shërbim efektiv”, Tiranë, 2015.
27. Heloísa B.A. Evangelista, Sidinei Magela Thomaz and Cristiane Akemi Umetsu, An analysis of publications on invasive macrophytes in aquatic ecosystems, 4 December 2013 / Accepted: 20 August 2014 / Published online: 1 October 2014.

11.CV E STUDENTEVE

Dorentina Lushaj e lindur me 02.02.1997 në Prizren. Me kombësi Shqipëtare dhe nënshtetësi Kosovare, jeton në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme të ulët e kreu në Sh.F.M.U "Haziz Tola" në vitin 2012 në Prizren. Pastaj shkollën e mesme të lartë e kreu në Sh.M.L.M. "Luciano Motroni" në vitin 2015 dhe diplomoi në drejtimin "Asistente e Infermierisë së përgjithshme". Më pas studimet universitare i ndjeki në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", në Fakultetin e Mjekësisë drejtimi i Infermierisë së përgjithshme në vitin 2015 dhe mori titullin Bachelor i Infermierisë së Përgjithshme në vitin 2019.

Besarta Biraj e lindur me 07.10.1996 në Prizren. Me kombësi Shqipëtare dhe nënshtetësi Kosovare, jeton në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme të ulët e kreu në Sh.F.M.U "Haziz Tola" në vitin 2012 në Prizren. Pastaj shkollën e mesme të lartë e kreu në Sh.M.L.M. "Luciano Motroni" në vitin 2015 dhe diplomoi në drejtimin "Asistente e Infermierisë së përgjithshme". Më pas studimet universitare i ndjeki në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", në Fakultetin e Mjekësisë drejtimi i Infermierisë së përgjithshme në vitin 2015 dhe mori titullin Bachelor i Infermierisë së Përgjithshme në vitin 2019.

12.SHTOJCA

Ju lutem te shkruani pergjigjen e sakte ose me te perafert!

Gjinia:

- a. F
- b. M

Mosha:

Jeni i/e punesuar ne sektorin:

- a. Privat
- b. Publik

Jeni i/e punesuar ne nivelin:

- a. Primar (Mjekesi Familjare)
- b. Sekondar (Spital)
- c. Terciar (QKUK)

Nese punoni ne nivelin sekondar ose terciar ne cilin repart punoni:

Me cilin grupacion te popullates punoni me teper gjate punes se perditshme:

- a. Femije
- b. Adult
- c. Femra
- d. Te moshuar

Shenoni dy arsye kryesore per te cilat te moshuarit kerkojne sherbim te ju:

Te moshuarit qe kerkojne sherbim ne Institucionin ku punoni vijne:

- a. Me percjelles
- b. Pa percjelles

A ekziston pritore ne Institucionin tuaj?

- a. Po
- b. Jo

A ekziston shtegu i vecuar per levizje me karroce prane hyrjes ne Institucionin tuaj?

- a. Po
- b. Jo

A ekziston shtegu i vecuar per levizje me karroce ne (brenda) Institucionin tuaj?

- a. Po
- b. Jo

A ka institucioni juaj lift (ashensore)?

- a. Po
- b. Jo

A eshte lifti (ashensori) funksional?

- a. Po
- b. Jo

A ka ne qytetin tuaj Shtepi te Pleqeve?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

A ka ne qytetin tuaj ndonje aktivitet per te moshuarit?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

Nese Po cili eshte aktiviteti?

A ka ne qytetin tuaj ndonje lehtesi per te moshuarit?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di

Nese Po cila eshte lehtesira?

A ekziston sigurim shendetesor publik ne vendin tuaj?

A duhet pacienti qe te siguroj (bleje) vet medikamente?

- a. Po
- b. Jo

Nese Po, cilat medikamente?

A keni te moshuar ne familje:

- a. Po
- b. Jo

Nese Po, a jetoni bashke me te moshuar?

- a. Po
- b. Jo

Gjate pervojës suaj profesionale, a keni ofruar ndonjehere ndihme (kujdes, terapi, injeksione, keshilla, etj.) ne shtepi te moshuarit?

- a. Po

b. Jo

Per mendimin tuaj, cila do te ishte gjeja me kryesore qe do ta kishit realizuar ne menyre qe te permiresohen kushtet e te moshuarve?

Jam njoftuar me anketen anonime dhe pajtohem te i pergjigjem!

Nenshkrimi: